



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E VERIFIKIMIT**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____. _____. 2018

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 40, Datë 17.05.2018

MONITORIM I KRYER NGA APP

Autoriteti Kontraktor	AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE, TIRANË
Hetim administrativ, iniciuar nga	• APP ☒ • Reklamim nga të tretë ☐
Numri i procedurave të monitoruara	1
Lloji i procedurës/ave të monitoruara	Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës
Konstatimet kryesore	Nga shqyrtimi i gjithë informacionit të administruar, në kuadër të hetimit administrativ, Agjencia e Prokurimit Publik arriti në përfundimin se, autoriteti kontraktor, nuk ka provuar dhe justifikuar krijimin e situatës emergjente dhe domosdoshmërinë e përdorimit të procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, në kundërshtim me kërkesat e nenit 33, pika 2, gërma "c" të ligjit të prokurimit publik dhe nenit 36, pika 2, gërma "c" të rregullave të prokurimit publik. Autoriteti kontraktor nuk ka administruar dokumentacion, në lidhje me argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit, në kundërshtim me nenin 61 të rregullave të prokurimit publik. Gjithashtu, autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar dhe dokumentuar me anë të një procesverbali të mbajtur për këtë qëllim, mënyrën e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë që do të ftojë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 6 të ligjit të prokurimit publik dhe nenit 36, pika 4 të rregullave të prokurimit

	publik.
Masat e marra	Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të nenit 72, pika 1, gërma “e” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka penalizuar me gjobë 4 (katër) persona, konkretisht: Titullari i autoritetit kontraktor dhe 3 (tre) anëtarë të Njësisë së Prokurimit.